



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

Gjetjet kryesore të Anketës “COVID-19 MBI BIZNESET”

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

QERSHOR 2020

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje

2. Qëllimi i Anketimit

3. Metodologjia

4. Kampioni

5. Fakte Kryesore

6. Ndikimi i COVID-19

7. Implikimet ndaj Biznesit

8. Ndërhyrjet e Qeverisë

9. Teknologjia dhe Biznesi


10. Plani i Emergjencës



Hyrje

Pas përhapjes së COVID-19 në Shqipëri, Këshilli i Ministrave vendosi të shpallte gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Në përgjigje të situatës së jashtëzakonshme, Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI) në bashkëpunim të ngushtë me MFE, nisi një anketim mbi “Vlerësimin e Ndikimit të Pasojave që rrjedhin nga Pandemia e COVID-19 mbi Aktivitetin e Biznesit në Shqipëri”, me qëllim identifikimin e problematikave kryesore dhe sugjerimet për përballjen e situatës nga perspektiva e biznesit.

Ky raport paraqet rezultatet e anketimit që filloi më 28 Mars dhe vazhdoi deri më 5 maj 2020.





Qëllimi i Anketimit

- Anketimi mbi "**Vlerësimin e Ndikimit të Pasojave që Rrjedhin nga Pandemia COVID-19 mbi Aktivitetin e Biznesit në Shqipëri**" është një iniciativë e Sekretariatit të KI në bashkëpunim me MFE. Ky sondazh synon evidentimin e informacionit në lidhje me efektet e mundshme të pandemisë COVID-19 në aktivitetet e biznesit.
- Që nga viti 2015, Sekretariati i KI vazhdimisht ka ndërmarrë anketime me qëllim hartimin e analizave dinamike për vlerësimin e masave fiskale dhe anti-informalitet në klimën e investimeve në vend. Gjetjet e sondazheve janë gjithmonë objekt diskutimi në mbledhjet e Këshillit të Investimeve. Rekomandimet e miratuara nga Këshilli i Investimeve i paraqiten qeverisë shqiptare për analiza të mëtejshme, proces i cili pritet të sjellë ndryshime ose rishikime të mundshme ligjore dhe rregullatore me ndikim në klimën e investimeve.

Metodologjia

01

Analiza e të dhënave

U zgjodh metoda e vrojtimit të thjeshtë me zgjedhje të rastit. Kampionimi i rastësishëm është forma më e pastër e probabilitetit ku secili anëtar i popullatës ka një shans të barabartë për tu zgjedhur.

Përftimi i të dhënave

Për mbledhjen e të dhënave u përdorën pyetorë online, si metoda me kosto më efektive si edhe për të arritur maksimumin e kompanive.

03

Pjesëmarrja

Pyetorët iu përgjigjën 833 kompani të shpërndara në të 12 qarqet e Shqipërisë.

02



Fakte dhe Gjetje Kryesore





Fakte Kryesore

97%

E kompanive presin që aktiviteti i tyre të ndikohet negativisht dhe shumë negativisht nga përhapja e COVID-19

86%


E kompanive deklarojnë se nuk kanë një plan të aprovuar emergjence

80%

E kompanive vlerësojnë se do të kenë më shumë se 20% rënie të qarkullimit vjetor të tyre


Ndikimi i COVID-19

COVID-19 ka ndikuar negativisht bizneset në çdo sektor të ekonomisë. Pyetja “Si e vlerësoni ndikimin e COVID-19 në aktivitetin tuaj?” dha këto përfundime:




Sektori i shërbimeve dhe ai i turizmit patën përqindjen më të lartë të përgjigjeve me “ndikim negativ / shumë negativ”.

COVID-19 detyroi pothuajse gjysmën e ekonomisë shqiptare të mbyllej. Pyetja “A e ndërpretë aktivitetin tuaj si rezultat i COVID19?” dha këto përfundime:



Më të prekura nga mbyllja shfaqen sektori i turizmit ku 94% e sektorit ndaloi punën plotësisht ose pjesërisht. Në të kundërt, sektori i buqësisë shfaqet më pak i prekur, më specifikisht 24% e kompanive të mbyllura plotësisht.

COVID-19 uli në mënyrë drastike pritshmëritë e kompanive për sa i përket xhiros së tyre vjetore



Kompanitë me një qarkullim vjetor deri në **14 milion** lekë vlerësojnë një humbje **më të madhe** për shkak të situatës pandemike në krahasim me kompanitë me qarkullim më të madh se 14 milion lekë.

Për sa i përket sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, në përgjithësi pritshmëritë konvergjojnë. **Bujqësia** paraqitet sektori me pritshmëri më pak negative kundrejt uljes së të ardhurave.




COVID-19 Implikimet ndaj Biznesit

Mungesa e klientëve dhe Mungesa e likuiditetit për shkak të shfaqjes së COVID19, u kthyen në çështjet më problematike me të cilat u përballën të gjitha kompanitë **pavarësisht madhësisë së tyre**.


Nga ana tjetër, vështirësitë në përmbushjen e detyrimeve **tatimore ishin më sfiduese për kompanitë e vogla**, ndërsa kompanitë e mëdha kishin vështirësi në pagesën e pagave.

Për shkak të pandemisë COVID-19, kompanitë u përballën me sfida unike. Pyetja "Cilat janë tre problemet më kryesore me të cilat po ndeshet aktualisht kompania juaj?" dha këto rezultate:



Për shkak të situatës së jashtëzakonshme COVID-19, kompanitë në Shqipëri, kryesisht në industri, hasën probleme me furnizimin e lëndëve të para nga importet, ndërsa disa prej tyre po konsiderojnë burimet e brendshme si një opsion.

Përgjigjet e kompanive konfirmojnë varësinë më të madhe nga importet të sektorit të industrisë ku **83%** e kompanive deklarojnë se varen plotësisht nga importet, ndërsa sektori i ndërtimit është ai më pak i varuri ku **29%** e kompanive deklarojnë se varen plotësisht nga importet.




52%

E kompanive janë perballur me problematika në lidhje me furnizimin nga importi.


69%

E kompanive deklaruan se biznesi i tyre mund të dëmtohet seriozisht pasi ato varen plotësisht nga importet.


Për shkak të pandemisë COVID-19, rutina klasike e punës ndryshoi në mënyrë drastike dhe bizneset nuk ishin të përgatitur se si të reagonin. Kështu, pyetja "Çfarë masash ndërmori kompania juaj për të adresuar mungesën e fuqisë punëtore?" dha këto rezultate:



Largimet nga puna u zbatuan kryesisht nga industria (30%), turizmi (30%) dhe shërbimet (28%); ndërsa puna në distancë nga shtëpia u përdor kryesisht nga Shërbimet (66%).



COVID-19 u kthye në kërcënim serioz ndaj vijimësisë së biznesit. Për shkak të pasojave që rrjedhin nga situata e paprecedentë, për të siguruar vazhdimësinë, biznesi duhet të reagojë dhe të garantonte burimet e nevojshme financiare. Në përgjigje të pyetjes "Cilat janë masat që do të ndërmerrni për të siguruar vazhdimësinë e biznesit tuaj?" rezultojnë sipas industrive:



34%

E kompanive sigurojnë vazhdimësinë nëpërmjet të ardhurave nga periodha të mëparshme.


32%

E kompanive sigurojnë vazhdimësinë nëpërmjet uljes së kostove.

23%

E kompanive sigurojnë vazhdimësinë nëpërmjet kredive bankare.

Kur u pyetën "Sa mendoni se do të zgjasin efektet negative të COVID-19 në veprimtarinë tuaj?", biznesi ka pothuajse të njëjtat pritshmëri.




Pavarësisht nga madhësia, shumica e ndërmarrjeve vlerësojnë se ndikimi COVID-19 do të zgjasë deri në 1 vit. Sipas sektorëve të ekonomisë, ndërtimi, tregtia, turizmi, shërbimet dhe industria vlerësojnë se ndikimi COVID-19 do të zgjasë deri në 1 vit, vetëm Bujqësia vlerëson një ndikim deri në 6 muaj.



Ndërhyrjet e Qeverisë

COVID-19 vërtetoi se mbështetja e qeverisë është e pazëvendësueshme në situata të panjohura për të siguruar vazhdimësinë e biznesit. Kur u pyetën "Cilat nga masat e prezantuara nga qeveria mendoni se do të kenë ndikimin më pozitiv tek minimizimi i efekteve negative?", rezultatet ishin si më poshtë.




Kompanitë mbi **14 milion lekë** vlerësojnë se pagesa e kredive do të ketë ndikimin më **pozitiv**;

Biznesi me qarkullim **deri në 14 milion lekë** vlerëson se mbështetja financiare për punonjësit do të ketë një ndikim **pozitiv**.

COVID19 - Teknologjia dhe Biznesi


COVID-19 ndërgjegjësoi kompanitë mbi efikasitetin e shërbimeve online. Kur u pyetën "A i keni përdorur shërbimet elektronike në këtë periudhë?", 75% e kompanive deklaruan se kanë përdorur shërbimet online.

Më tej, kur u pyetën rreth 81% e kompanive pranuan se do t'i ripërdorin ato në të ardhmen.



Për sa i përket planeve të ardhshme të investimeve në inovacion, përgjigja e pyetjes "Në të ardhmen, a mendoni se do të ndryshojnë planet tuaja të investimit, drejt ofrimit të shërbimeve online?" kishte gjithsej 38% përgjigje pozitive.

Investimet do të përqendrohen kryesisht në **teknologji të reja**.




Plani i Emergjencës

Kompanitë që operojnë në Shërbime dhe industri janë më të përgatitur për t'u përballur me raste emergjence

Kompanitë e ndërtimit dhe tregtisë janë më pak të përgatitur.

COVID-19 vërtetoi që kompanitë shqiptare janë seriozisht të papërgatitur për të përballuar situata të paparashikuara. Kompanitë në Shqipëri nuk kanë plan emergjence (86% e kompanive nuk kanë plan të aprovuar emergjence). Sjellja është e njëjtë pavarësisht nga madhësia apo sektori ekonomik.






Gjetjet kryesore të Anketës “COVID-19 MBI BIZNESET”

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

QERSHOR 2020

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështjet Ekonomike (SECO)



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO